

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KOMPANIA UJËSJELLËSI RAJONAL PRISHTINA SH.A.**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **70433736-26-509-2-2-1**

Sa i përket tenderit për **Atestimi i vinçave dhe riparimi i tyre_Lot 1, Atestimi i enëve për kundërgoditje_Lot 2 dhe Shqyrtime të paisjeve elektromakinerike_Lot 3**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	EALGA SH.P.K.
NUI	811862706
Adresa	Bulevardi Bill Klinton, BB 5/8 Hyrja D Nr.34
Vendi	Prishtinë,
Kodi postar	10000
Numri Telefonit	
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Ajshe Shala
Adresa elektronike	ealga.ks@gmail.com
Data e parashtrimit të ankesës	08.05.2026

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-it
Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Atestimi i vinçave dhe riparimi i tyre

Në bazë të tenderit të publikuar: Atestimi i vinçave dhe riparimi i tyre_Lot 1, Atestimi i enëve për kundërgoditje_Lot 2 dhe Shqyrtime të paisjeve elektromakinerike_Lot 3. me NRP: 70433736-26-509-2-2-1, në afatin e rregullt kohor parashtrijmë kërkesë për rishqyrtim:

04.03.2026 – Njoftim për Kontrate

25.03.2026 – Afati për dorëzimin e ofertave/kërkesës për pjesëmarrje

30.04.2026 – Njoftim Mbi Vendimin E Autoritetit Kontraktues

04.05.2026 – Kërkesa për Rishqyrtim

07.05.2026 – Vendim mbi refuzimin e kërkesës për Ri-shqyrtim

08.05.2026 – Ankesa në OSHP

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

04.05.2026 – Kërkesa për Rishqyrtim

07.05.2026 – Vendim mbi refuzimin e kërkesës për Ri-shqyrtim

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

AK me rastin e zbatimit të aktiviteti të prokurimit me titull: **Atestimi i vinçave dhe riparimi i tyre_Lot 1, Atestimi i enëve për kundërgoditje_Lot 2 dhe Shqyrtime të paisjeve elektromakinerike_Lot 3** me NRP: **70433736-26-509-2-2-1** për **Lot 1** nuk ka respektuar dispozitat Ligjit për Prokurim Publik nr. Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068, Nr. 05/L-092, dhe Udhëzuesin Operative dhe Rregulloret e Prokurimit si në vijim:

Nenin 1 të LPP-se

Nenin 7 të LPP-së - Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi

Nenin 52 të LPP_se

Nenin 55 të LPP_se

Nenin 59 të LPP_se

Neni 25 të RRPP 002/2024

Neni 25 të LPP-së

Neni 40 të RRPP 002/2024

Neni 10 i UOPP 001/2023

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Pretendimi 1:

Operatori Ekonomik (OE) ITEK nuk është trup inspektues i akredituar nga Drejtoria e Akreditimit e Kosovës (MINT-DAK) për inspektimin e vinçave. Për rrjedhojë, bazuar në legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës, ky operator nuk ka të drejtë ligjore të kryejë inspektime dhe të lëshojë certifikata të pranimit teknik për vinça.

OE ITEK nuk posedon autorizim apo akreditim valid nga MINT-DAK. Dokumenti i paraqitur në ofertë si dëshmi autorizimi është dokument i skaduar që nga data 28.02.2015. Këtë mund ta shihni në Dokumentin 1 në Aneksin me Dokumente i cili është ngarkuar sëbashku me ankesën. Në vetë dokumentin është e specifikuar qartë se vlefshmëria e tij ka përfunduar më 28.02.2015. Megjithatë, Autoriteti Kontraktues, në përgjigjen ndaj kërkesës sonë për rishqyrtim, ka prezantuar të njëjtin dokument duke pretenduar se OE ITEK posedon autorizim valid.

1/2012

25.02. 2015

Vlefshmëria/Validity/Vazi do

Ne, si EALGA SH.P.K., jemi plotësisht të informuar lidhur me këtë proces, duke qenë aktivë për më shumë se 25 vite në këtë treg. Gjithashtu, edhe ne kemi qenë të autorizuar gjatë viteve 2014–2015 me dokument të njëjtë sikurse OE ITEK. Mirëpo, në vitin 2015, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT) (atëherë MTI) ka zëvendësuar sistemin e autorizimit për vinça me sistemin e akreditimit nga MINT-DAK.

Akreditimi lëshohet me afat katër (4) vjeçar dhe vazhdohet çdo katër vite. EALGA SH.P.K. është e akredituar sipas kërkesave ligjore dhe akreditimi ynë është vazhduar së fundmi në vitin 2022, me vlefshmëri deri në nëntor 2026 (shih Dokumentin 2 në Aneks). Ndërsa OE ITEK, edhe pse ka poseduar autorizim në vitin 2015, nuk e ka vazhduar atë dhe nuk është harmonizuar me rregullat e reja ligjore, respektivisht nuk ka marrë akreditim nga MINT-DAK. Si rezultat, i vetmi dokument që posedon është autorizimi i skaduar i vitit 2015 (Dokumentin 1 në Aneks), i cili nuk ka më asnjë vlefshmëri juridike.

Për të verifikuar listën e trupave inspektues të akredituar nga MINT-DAK për inspektim dhe certifikim të vinçave, mund t'i referoheni Dokumentit 3 në Aneks ose të kontaktoni drejtpërdrejt MINT-DAK për të konfirmuar se OE ITEK nuk posedon akreditim valid për inspektim dhe certifikim të vinçave.

Akreditimi nga MINT-DAK sipas standardit ISO/IEC 17020 është obligativ në Republikën e Kosovës për kryerjen e inspektimeve dhe certifikimeve të vinçave.

Sa i përket bazës ligjore, në përputhje me Ligjin Nr. 05/L-117 për Akreditimin, konkretisht nenet 3, 6, 9, 12 dhe 15, aktivitetet e inspektimit, testimit dhe certifikimit teknik të vinçave klasifikohen si aktivitete të vlerësimit të konformitetit, të cilat mund të kryhen vetëm nga trupa të akredituar nga autoriteti i vetëm kompetent në Republikën e Kosovës, përkatësisht MINT-DAK.

Sipas këtij ligji, akreditimi përbën dëshminë e vetme zyrtare të kompetencës teknike dhe profesionale për kryerjen e këtyre aktiviteteve. Rrjedhimisht, çdo subjekt apo individ i paakredituar konsiderohet juridikisht jokompetent për të kryer inspektime teknike dhe për të lëshuar certifikata të vlefshme.

Duke qenë se OE ITEK nuk posedon akreditim valid nga MINT-DAK, i cili përbën licencimin/certifikimin e vetëm obligativ në Republikën e Kosovës për kryerjen e inspektimit dhe certifikimit të vinçave, atëherë OE ITEK nuk e përmbush kushtin e kapacitetit teknik dhe profesional të përcaktuar në Pikën 9.2 të Dosjes së Tenderit (respektivisht pika III.2.4 në Njoftimin për Kontratë), konkretisht kërkesën "Lot 1 _ Kërkesa 2", dhe si i tillë duhet të shpallet operator ekonomik i papërgjegjshëm për Lot 1 të këtij tenderi.

Pretendimi 2:

Licenca e paraqitur nga OE ITEK, e lëshuar nga Ministria e Punës (Dokumenti 6 në Aneks), nuk përbën licencë për inspektim dhe certifikim të vinçave. Në këtë licencë askund nuk përmendet termi "vinç" apo "pajisje ngritëse". Për më tepër, nuk ekziston asnjë bazë ligjore që kjo licencë të përdoret për inspektimin dhe certifikimin e pajisjeve komplekse makinerike siç janë vinçat.

Lidhur me këtë çështje, ne kemi zhvilluar komunikime edhe me përfaqësues të Ministrisë së Punës, përfshirë ministrin dhe ushtruesin e detyrës së drejtorit të Inspektoratit Qendror të Punës. Në këto komunikime është sqaruar se kjo licencë u mundëson operatorëve ekonomikë të kontrollojnë pajisje pune që nuk janë të rregulluara me ligje apo akte të veçanta, si p.sh.: dana, këpucë mbrojtëse, helmata, mistri, çekiçë, nivelues, lopata, dalta dhe pajisje të ngjashme pune. Mirëpo, kjo licencë në asnjë mënyrë nuk autorizon operatorët ekonomikë të kryejnë inspektim dhe certifikim të pajisjeve të rënda, komplekse dhe me rrezikshmëri të lartë, siç janë vinçat.

Kompanitë e pajisura me këtë licencë nga Ministria e Punës obligohen vetëm të

verifikojnë nëse në vendpunishte vinçat posedojnë certifikata valide të lëshuara nga trupa inspektues të akredituar nga Drejtoria e Akreditimit e Kosovës (MINT-DAK). Ato nuk janë të autorizuar që vetë të kryejnë inspektimin dhe certifikimin teknik të vinçave.

Për më tepër, procesi i pajisjes me këtë licencë nga Ministria e Punës nuk kërkon angazhimin e inxhinierëve të specializuar, posedimin e pajisjeve matëse profesionale me vlerë të lartë, trajnime profesionale të kushtueshme, kalibrime periodike vjetore, ri-trajnime dhe riakreditime çdo katër (4) vite. Për këtë arsye, kjo licencë nuk mund të konsiderohet si dëshmi e kompetencës profesionale dhe teknike për inspektimin e vinçave.

Nëse do të lejohej që inspektimi dhe certifikimi i vinçave të kryhej vetëm me licencë nga Ministria e Punës, pa akreditim nga MINT-DAK, atëherë i gjithë procesi i akreditimit i cili kërkon të gjithë hapat e lartëpërmendur do të humbte kuptimin dhe do të bëhej i panevojshëm dhe MINT-DAK nuk do të egzistonte.

Autoriteti Kontraktues ka tentuar ta interpretojë në mënyrë të përgjithësuar pikën e licencës së ministrisë së punës që i referohet "inspektimit dhe testimit sistematik të mjeteve të punës". Mirëpo, nocioni "mjete pune" përfshin edhe automjete si kamionë dhe vetura të përdorura në vendpunishte. Duke ndjekur logjikën e Autoritetit Kontraktues, atëherë operatorët ekonomikë me këtë licencë do të mund të kryenin edhe kontrollin teknik të automjeteve pa qenë të autorizuar si qendra të kontrollit teknik, gjë që është juridikisht dhe praktikisht e papranueshme.

Ashtu sikurse automjetet mund të kontrollohen vetëm në qendra të licencuara të kontrollit teknik, edhe vinçat mund të inspektohen dhe certifikohen vetëm nga trupa inspektues të akredituar nga MINT-DAK. Ndërsa operatorët ekonomikë të pajisur vetëm me licencë nga Ministria e Punës mund të kontrollojnë vetëm pajisje të thjeshta pune për të cilat nuk ekziston ndonjë regjim i veçantë akreditimi apo ligj specifik.

Pra OE ITEK nuk është trup inspektues i akredituar nga MINT-DAK për inspektimin e vinçave. Për rrjedhojë, bazuar në legjislacionin në fuqi, ky operator nuk ka të drejtë të kryejë inspektime dhe të lëshojë certifikata të pranimit teknik të vinçave, dhe çdo certifikatë e lëshuar prej tij konsiderohet e pavlefshme dhe joligjore.

Ngjashëm sikurse tek Pretendimi1, duke qenë se OE ITEK nuk posedon akreditim valid nga MINT-DAK, i cili përbën licencimin/certifikimin e vetëm obligativ në Republikën e Kosovës për kryerjen e inspektimit dhe certifikimit të vinçave, atëherë OE ITEK nuk e përmbush kushtin e kapacitetit teknik dhe profesional të përcaktuar në Pikën 9.2 të Dosjes së Tenderit (respektivisht pika III.2.4 në Njoftimin për Kontratë), konkretisht kërkesën "Lot 1 _ Kërkesa 2", dhe si i tillë duhet të shpallet operator ekonomik i papërgjegjshëm për Lot 1 të këtij tenderi.

Pretendimi 3:

Trajnimi për standardin ISO/IEC 17020 i paraqitur nga OE ITEK në ofertë (Dokumenti 4 në Aneks) nuk përbën dhe në asnjë mënyrë nuk mund të zëvendësojë certifikatën e akreditimit ISO/IEC 17020 të lëshuar nga Drejtoria e Akreditimit e Kosovës (MINT-DAK).

Kjo dëshmi e paraqitur nga OE ITEK është vetëm një trajnim profesional/parapërgatitje për procesin e akreditimit dhe nuk përfaqëson akreditim zyrtar të kompanisë. Për më tepër, ky trajnim i është lëshuar individit dhe jo kompanisë si subjekt juridik. Kjo mund të verifikohet lehtësisht duke krahasuar dokumentin e paraqitur nga OE ITEK me certifikatën tonë të akreditimit (Dokumenti 5 në Aneks), e cila është e lëshuar për kompaninë EALGA SH.P.K. dhe përmban afat të qartë vlefshmërie katër (4) vjeçare.

Ndryshe nga certifikatat e akreditimit, certifikatave të trajnimit nuk u përcaktohet afat skadence në dokument. Megjithatë, sipas praktikave dhe kërkesave të procesit të akreditimit, trajnimet e përdorura si bazë për akreditim duhet të jenë jo më të vjetra se katër (4) vite. Rrjedhimisht, edhe ky trajnim i paraqitur nga OE ITEK është i vjetërsuar dhe nuk mund të përdoret si dëshmi valide as për aplikim për akreditim e lëre më të zëvendësojë atë.

Pra OE ITEK nuk është trup inspektues i akredituar nga MINT-DAK për inspektimin e vinçave. Për rrjedhojë, bazuar në legjislacionin në fuqi, ky operator nuk ka të drejtë të kryejë inspektime dhe të lëshojë certifikata të pranimit teknik të vinçave, dhe çdo certifikatë e lëshuar prej tij konsiderohet e pavlefshme dhe joligjore.

Ngjashëm sikurse tek Pretendimi 1, duke qenë se OE ITEK nuk posedon akreditim valid nga MINT-DAK, i cili përbën licencimin/certifikimin e vetëm obligativ në Republikën e Kosovës për kryerjen e inspektimit dhe certifikimit të vinçave, atëherë OE ITEK nuk e përmbush kushtin e kapacitetit teknik dhe profesional të përcaktuar në Pikën 9.2 të Dosjes së Tenderit (respektivisht pika III.2.4 në Njoftimin për Kontratë), konkretisht kërkesën "Lot 1 _ Kërkesa 2", dhe si i tillë duhet të shpallet operator ekonomik i papërgjegjshëm për Lot 1 të këtij tenderi.

Pretendimi 4:

OE ITEK nuk ka dëshmuar se posedon qarkullim financiar në vlerë prej së paku 16,500.00 Euro në fushën e inspektimit dhe certifikimit të vinçave, ashtu siç kërkohet në

Dosjen e Tenderit.

Në referencat e paraqitura nga OE ITEK në ofertë (Dokumentet 7, 8 dhe 9 në Aneks), nuk është specifikuar vlera financiare në Euro e punëve të kryera. Rrjedhimisht, nga këto referenca nuk mund të vërtetohet se OE ITEK ka realizuar qarkullim të mjaftueshëm në fushën e inspektimit dhe certifikimit të vinçave.

Dosja e Tenderit kërkon qartë që operatori ekonomik të dëshmojë qarkullim në këtë fushë në vlerë prej 1.5 herë më të lartë se vlera e parashikuar për Lotin përkatës. Për Lot 1, vlera e parashikuar është 11,000.00 Euro, ndërsa qarkullimi minimal i kërkuar është:
 $11,000 \times 1.5 = 16,500$ Euro

<p>Lot 1,2 dhe 3_Kerkesa 4. Operatori Ekonomik (tenderuesi) me rastin e dorëzimit të tenderit duhet të vërtetojë se ka kryer një apo disa kontrata për shërbime të ngjashme për Lot 1_Atestimi i vinçave, dhe ose Lot 2_Atestimi i enëve për kundërgoditje Albanik dhe ose Lot 3_Shqyrtime të pajisjeve elektromakinerike, në tri vitet e fundit, duke filluar numerimi prapa nga data e njoftimit për kontratë, të cilat vetëm ose së bashku arrijnë totalin e vlerës prej 1.5 HERE të vlerës së parashikuar të pjesës-lot-it përkatës për të cilin ofertohej. (Në rast të tenderimit në grup, Udheheqesi i grupit duhet të ketë përfunduar së paku 60% të furnizimeve nga vlera e mesiperme).</p>	<p>Lot 1,2,dhe 3_Evidenca 4. Kur furnizimi është bërë për një autoritet publik në Kosovë ose në një vend tjetër, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e certifikatës (certifikata raporti i përkohshëm i pranimit) të rëndësishme të lëshuar ose të bashkë-nënshkuara nga autoriteti i tillë. Të gjitha këto dëshmi duhet të kenë vlerën e realizuar. (ii) kur furnizimi është bërë për një blerës privat, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e çdo dokumenti të nënshkuar nga blerësi dhe evidentimi i livrimit të tillë me dëshmi të pagesës nga banka;</p>
--	--

2.6	Vlera e parashikuar: Pjesa/Lot 1: 11,000.00 € Pjesa/Lot 2: 4,000.00 € Pjesa/Lot 3: 20,000.00 €
-----	---

Meqenëse OE ITEK nuk ka paraqitur dëshmi të mjaftueshme dhe të verifikueshme për realizimin e këtij qarkullimi 16,500.00 Euro, atëherë OE ITEK nuk e përmbush kushtin e kapacitetit teknik dhe profesional të përcaktuar në Pikën 9.2 të Dosjes së Tenderit (respektivisht pika III.2.4 në Njoftimin për Kontratë), konkretisht kërkesën "Lot 1,2 dhe 3_Kerkesa 4", dhe si i tillë duhet të shpallet operator ekonomik i papërgjegjshëm për Lot 1 të këtij tenderi.

Pretendimi 5:

OE ITEK ka dorëzuar në mënyrë të jashtëligjshme referenca pas afatit për dorëzimin e ofertave, në kundërshtim me rregullat dhe parimet e procedurës së prokurimit publik.

Ligji për Prokurimin Publik dhe praktika e Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) përcaktojnë qartë se gjatë fazës së kërkesave për sqarime nuk lejohet dorëzimi i dokumenteve substanciale që nuk kanë ekzistuar në momentin e dorëzimit të ofertës. Sqarimet mund të përdoren vetëm për të qartësuar dokumente ekzistuese dhe jo për të krijuar apo plotësuar më vonë dokumentacion thelbësor që mungon në ofertë.

Në rastin konkret, Referenca nga OE EuroLab (Dokumenti 8 në Aneks) është lëshuar me datë 02.04.2026 dhe Referenca nga OE MobileriDekra (Dokumenti 7 në Aneks) është lëshuar me datë 06.04.2026.

Ndërkohë, oferta për këtë tender është dorëzuar nga OE ITEK më datë 25.03.2026, e cila ka qenë edhe data e fundit për dorëzimin e ofertave.



Kjo nënkupton se në momentin e dorëzimit të ofertës, këto referenca nuk kanë ekzistuar fare. Për rrjedhojë, nuk kemi të bëjmë me ndonjë gabim teknik apo administrativ të OE ITEK, siç mund të ishte mosngarkimi aksidental i një dokumenti ekzistues, por me dokumente të krijuara pas përfundimit të afatit ligjor për ofertim.

Pranimi i këtyre dokumenteve nga Autoriteti Kontraktues përbën trajtim të pabarabartë dhe cenim të parimeve themelore të prokurimit publik, përfshirë parimin e transparencës, trajtimin e barabartë të operatorëve ekonomikë, konkurrencën e drejtë dhe respektimin e afateve ligjore të procedurës.

Për më tepër, kjo situatë krijon dyshime serioze për favorizim të OE ITEK nga ana e Autoritetit Kontraktues, duke i mundësuar këtij operatori plotësimin e dokumentacionit substancial pas afatit ligjor për dorëzimin e ofertave. Prandaj, edhe kjo përbën arsye shtesë ligjore dhe procedurale që OE ITEK të shpallet operator ekonomik i papërgjegjshëm për Lot 1 të këtij tenderi.

Pretendimi 6:

Duke pasur parasysh se OE ITEK ka paraqitur autorizim të skaduar prej më shumë se 11

viteve, ekziston dyshim serioz dhe mundësi e lartë që edhe certifikatat e kalibrimit të pajisjeve matëse të paraqitura në ofertë të jenë të skaduara ose jo valide sipas standardeve përkatëse.

Pajisjet matëse që përdoren për inspektimin dhe certifikimin e vinçave duhet të kalibrohen në mënyrë periodike nga kompani të certifikuara për kalibrim sipas standardeve ISO përkatëse. Sipas praktikave dhe kërkesave të standardeve ISO, certifikatat e kalibrimit zakonisht lëshohen me vlefshmëri maksimale prej një (1) viti.

Për rrjedhojë, ju lutem shiqoni nëse certifikatat e kalibrimit të paraqitura nga OE ITEK janë certifikata ISO dhe valide, ne nuk i kemi parë ato sepse nuk janë dërguar nga AK në përgjigjen e kërkesës për rishqyrtim. Nëse certifikatat nuk përmbajnë afat të vlefshmërisë, ato gjithashtu duhet të konsiderohen të pavlefshme pas kalimit të periudhës njëvjeçare nga data e lëshimit.

Në Dosjen e Tenderit janë kërkuar katër (4) pajisje të kalibruara për realizimin e shërbimeve të kërkuara. Nëse rezulton se ndonjëra nga certifikatat e kalibrimit është e skaduar, jo valide ose nuk është e lëshuar sipas standardeve relevante ISO, atëherë kjo përbën arsye shtesë që OE ITEK të shpallet operator ekonomik i papërgjegjshëm. Më saktësisht OE ITEK nuk e përmbush kushtin e kapacitetit teknik dhe profesional të përcaktuar në Pikën 9.2 të Dosjes së Tenderit (respektivisht pika III.2.4 në Njoftimin për Kontratë), konkretisht kërkesën "Lot 1_Kerkesa 3", dhe si i tillë duhet të shpallet operator ekonomik i papërgjegjshëm për Lot 1 të këtij tenderi.

Pretendimi 7:

Në procedurat e mëparshme të prokurimit të zhvilluara nga KRU Prishtina për shërbimet e inspektimit të vinçave, si p.sh. tenderi me numër 70433736-23-4491-1-2-1 i vitit 2023, është kërkuar në mënyrë eksplicite që operatorët ekonomikë të dëshmojnë akreditim nga Drejtoria e Akreditimit e Kosovës (MINT-DAK) për inspektim të vinçave, si pjesë e kapacitetit teknik (pika III.2.4, kërkesa 2).

Kerkesa 2.Operatori ekonomik (tenderuesi) me ofertën e tij, duhet të vërtetojë se është i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit ose ndonjë organet tjetër shtetror,	Evidenca 2.Certifikata e akreditimit për atestim të vinçave.
--	---

Megjithatë, në tenderin më të fundit me numër 70433736-26-509-2-2-1, kjo kërkesë esenciale mungon në Dosjen e Tenderit. Mungesa e këtij kriteri përbën shmangie nga praktikat e mëparshme profesionale dhe nga standardet që sigurojnë sigurinë dhe

korrektësinë e inspektimit të pajisjeve të rënda si vinçat.

Kjo situatë ka rezultuar në deformim të kërkesave profesionale dhe teknike, duke krijuar paçartësi të qëllimshme për tua lejuar pjesëmarrjen në garë edhe të operatorëve ekonomikë që nuk dëshmojnë përmbushjen e kushteve ligjore dhe teknike për ushtrimin e kësaj veprimtarie të ndjeshme.

Në këtë kontekst, krijohet përshtypja e trajtimit jo të barabartë dhe potencialisht favorizues ndaj operatorëve ekonomikë përfshirë OE ITEK, duke i mjegulluar kërkesat dhe tentuar për tia mundësuar pjesëmarrjen në procedurë në mënyrë jo ligjore.

Për këtë arsye, konsiderojmë se edhe kjo rrethanë përbën një element shtesë që duhet të merret parasysh në vlerësimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë së procedurës, dhe rrjedhimisht mbështet qëndrimin se OE ITEK nuk përmbush kërkesat e nevojshme për kapacitet teknik dhe profesional për Lot 1 të këtij tenderi dhe duhet të shpallet operator ekonomik i papërgjegjshëm.

Përmes keqinterpretimit të fakteve, mosshqyrtimit serioz të ankesave tona, mosleximit ndoshta edhe të qëllimshëm të dokumenteve të skaduara të OE-ve të tjera, si dhe pranimit të dokumenteve pas afatit ligjor, AK po e degradon dhe po e cenon punën tonë 25-vjeçare në vendosjen e standardeve profesionale në këtë fushë.

E gjithë puna jonë me certifikime, licencime, pajisje me vlerë dhjetëra mijëra euro, trajnime profesionale me mijëra euro dhe tarifa akreditimi me mijëra euro, po barazohet me referenca nga mobileri dhe dokumente të skaduara para më shumë se 10 viteve, madje të dorëzuara edhe pas afatit.

Duke u bazuar në dëshmitë mbi shkeljet ne pikat ankimore të lartpërmendura kërkojmë nga OSHP që të marr:

VENDIM

ANULOHET - Njoftimi mbi vendimin e AK-se lidhur me aktivitetin e prokurimit me nr Prokurimit: **70433736-26-509-2-2-1** dhe titull: **Atestimi i vinçave dhe riparimi i tyre_Lot 1, Atestimi i enëve për kundërgoditje_Lot 2 dhe Shqyrtime të paisjeve elektromakinerike_Lot 3** , te inicuar nga AK **KOMPANIA UJËSJELLËSI RAJONAL PRISHTINA SH.A.**

APROVOHET:

Ankesa si e Bazuar dhe lënda: KTHEHET NE RI VLERESIM DHE VLERESIMI TE BEHET NE PERPUTHJE ME RRPP 002/2024 DHE LPP.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Demet e shkaktuara janë shpenzimet ne përgatitjen e ofertës, dëme ne reputacion dhe fitimi i humbur.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*